



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr 3322 prot

datë 20 / 02 /2020

VENDIM

Nr. 73 Datë. 20 . 02 2020

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS STANDARTE TË VEPRIMIT
"PËR ADMINISTRIMIN E OFRIMIT TË SHËRBIMIT TË PASTRIMIT NË
BASHKINË SHKODËR"**

Në mbështetje të nenit 8, 9, gërmës gj të nenit 64 të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", i ndryshuar, Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", Ligjit nr. 9010, datë 13.02.2003 "Për Administrimin Mjedisor të Mbetjeve të Ngurta", Ligjit nr.8094, datë 23.03.1996, "Për largimin publik të mbeturinave", Planit Lokal të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane 2017-2020 miratuar me VKB Nr.83,date 26.12.2017, Vendimit të Kryetares së Bashkisë së Shkodrës nr. 96, datë 20.03.2017 "Per miratimin e rregullores "Per organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administrates se Bashkise Shkoder" .

VENDOSA:

1. Miratimin e procedurës standarte të veprimit" Për administrimin e ofrimit të shërbimit të pastrimit në Bashkinë Shkodër" sipas materialit bashkëlidhur (20 faqe);
 2. Për zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet administrata e Bashkisë së Shkodrës sipas detyrave dhe përgjegjësiive të përcaktuara në këtë PSV dhe sipas rregullores "Per organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administrates se Bashkise Shkoder";
1. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

KRYETAR

Voltana Ademi

